

# RELACION

## PËR

### PROJEKTVENDIMIN

#### **“PËR STRUKTURËN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË FONDIT PYJOR, KRITERET TEKNIKE PËR EVIDENTIMIN DHE PASQYRIMIN E GJENDJES DHE TË NDRYSHIMEVE, MBAJTJA E TË DHËNAVE, INFORMACIONI QË REGJISTROHET DHE RAPORTIMI NGA ADMINISTRATORËT/PRONARËT E PYJEVE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të përcaktojë strukturën dhe modalitetet për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të Fondit PyJOR (RKFP). Njëkohësisht, nëpërmjet këtij projektvendimi përcaktohen kriteret teknike që do të përdoren për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit.

Fondi pyJOR kombëtar është objekt i zhillimit të aktiviteteve të shumëllojshme mbi të, e për pasojë në vetvete ai nuk mund të jetë statik, por në ndryshim e evolim të vazhdueshëm. Për këtë qëllim, evidentimi i ndryshimeve, mbajtja e tyre në një regjistër dhe krijimi i një portali informues për institucionet dhe të interesuarit është një tjetër synim i këtij projektvendimit.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projekt vendimi janë pikërisht:

- Të përcaktojë strukturën dhe modalitetet për ngritjen dhe funksionimin e RKFP.
- Të përcaktojë kriteret teknike dhe modalitetet për mbajtjen e informacionit ne RKFP.
- Të përcaktojë mënyrën e shkëmbimit dhe qarkullimit të informacionit ndërmjet instancave, format e raportimit dhe kohën e tyre.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për strukturën e regjistrit kombëtar të fondit pyJOR, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, formacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve”

### **III. ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij dokumenti është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2020, miratuar me VKM-në nr. 837, datë 24.12.2019.

Projektvendimi është parashikuar gjithashtu në ligjin 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", që lidhet e buron nga Dokumenti i Politikave për Pyjet 2019-2030, miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018. Në këtë dokument, janë planifikuar aktivitete dhe hapa të rëndësishëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, për të maksimizuar përfitimet dhe për të vendosur e ruajtur ekuilibrat natyrorë mbi të.

### **IV. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Gjendja e fondit pyjor është në një dinamikë të vazhdueshme, si pasojë e aktiviteteve që kryhen mbi të. Grumbullimi i informacioneve mbi gjendjen e tij dhe evidentimin e ndryshimeve që ndodhim mbi të, është i një rëndësie të veçantë, të cilat kanë lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Mbjajtja e këtij regjistri, pikë së pari krijon një historik të fondit pyjor kombëtar dhe të aktiviteteve që zhvillohen mbi të, duke siguruar të dhëna të vijueshme të cilat shërbejnë për vendimarrje si në aspektet e politikëbërjes ashtu dhe në ato të zhvillimit. Së dyti, krijimi i një formati unik raportimesh si në nivelin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar, është një tjetër vlerë e regjistrimit, dhe si rrjedhojë edhe e këtij projektvendimi.

Projekt vendimi i hap rrugën hartimit të një Udhëzuesi të ri, në të cilin do të përcaktohen në mënyrë të detajuar, kriteret teknike që do të përdoren për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qëndror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit.

Udhëzuesi në kontekstin e tij, do të orientojë strukturat përgjegjëse të pyjeve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, stafet e Agjencive Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe përdorues në nivele të tjera se si të përdorin Regjistrin, si të mbartin të dhënat dhesi të prodhojnë raportet nga sistemi.

### **V. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për strukturën e regjistrimit kombëtar të fondit pyjor, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, formacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve"

datë 30.04.2020, "Për pyjet". Ligji, në pikën 1 të nenit 6, citon shprehimisht: "Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) është regjistri zyrtar që ngrihet dhe mirëmbahet nga agjencia, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve kadastrale të nevojshme dhe e ndryshimeve periodike për çdo njësi të fondit pyjor kombëtar. Struktura e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit"

Projektvendimi është në harmoni të plotë me kushtetutën dhe nxirret mbështetur në nenin 100 të saj. Është gjithashtu në harmoni dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi vendas dhe atë ndërkombëtar.

## **VI. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektvendimi është dokument teknik i dalë në zbatim të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020, dhe nuk synon përafrim të legjislacionit.

## **VII. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT**

Projektvendimi është i strukturuar në katër krerë:

Në kreun I, të projektvendimit, "Dispozita të përgjithshme", jepen objektivat dhe qëllimi i projektvendimit, si dhe shpjegimi i terminologjisë së pëdorur në projektvendim.

Në kreun II, "Struktura e RKFP", të strukturuar në 5 pika, shpjegohet se si është e ndërtuar RKFP.

Në kreun III, "Kriteret teknike për evidentimin e gjendjes dhe të ndryshimeve në RKFP", projektvendimi saktëson se kush janë kriteret e funksionimit të këtij regjistri, të cilat detajohen në anekset 1 dhe 2, bashkëlidhur projektvendimit.

Kreu IV, "Informacioni i mbartur në RKFP, raportimi dhe afatet", përcaktohet tipi i informacionit, mënyra e qarkullimit të tij ndërmjet përdoruesve dhe administratorëve, si dhe jepen afatet e prodhimit të raporteve, në aneksin 2.

## **VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për strukturën e regjistrit kombëtar të fondit pyjor, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, formacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve"

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkitë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

#### **IX. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Dokumenti është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe projektvendimi është konsultuar me të gjitha strukturat e vartësisë të ministrisë.

Ky projektvendim do t'i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

#### **X. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i projektvendimit nuk ka kosto mbi buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për rrjedhojë as në buxhetin e shtetit.

Nga ana financiare ky dokument ofron lehtësi, pasi kërkuesit do të mund ta kërkojnë ofrimin e shërbimit nëpërmjet platformës *e-albania*.

**PROPOZUESI**

**MINISTËR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për strukturën e regjistrit kombëtar të fondit pyjor, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, formacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve"